



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7072 Prot.

Tiranë, më 15.01 2021

Të dhëna mbi Vendimin

Nr 04 datë 15, 01.2021

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "TIMAK" Shpk nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike, për *mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje makine teknologjike", të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Shërbimeve Funerale Divjake (në vijim "AK"), sipas nenit 13/3/ç të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar (në vijim "LPP").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "TIMAK" Shpk, me NIPT L62030020B, me adresë: Tirana Industrial Park, Nr. 16, Rruga "Egnatia", Kashar, Tiranë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "TIMAK" Shpk ka nisur mbi bazën e kërkesës Nr. 198 prot., datë 02.11.2020 të dërguar nga AK, me të cilën ky fundit i propozon APP-së nisjen e hetimit administrativ ndaj operatorit ekonomik "TIMAK" Shpk, për përjashtimin e tij nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, në zbatim të nenit 13/3/ç të LPP.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e *mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, brenda afateve të përcaktuara në rregullat e prokurimit*, sipas parashikimeve të nenit 13/3/ç të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 04, datë 12.01.2021 Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur të përjashtojë për 18 muaj operatorin ekonomik "TIMAK" Shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi ka vlerësuar si rrethana lehtësuese faktin që, operatori ekonomik "Timak" Shpk, nuk ka precedentë të mëparshëm për përjashtim nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

Ndërkohë që, si rrethanë rënduese konsiderohet fakti që me mosveprimet e tij, duke mosdorëzuar mjetin sipas kërkesave të përcaktuara, operatori ekonomik ka dëmtuar interesat e AK në plotësimin e nevojave të tij në kohë, me mjetin teknologjik.